



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.633/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja VETËVENDOSJE! me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë administrimit dhe numërimit të votave nga jashtë Kosovës – votave me postë, në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR) në Prishtinë, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.03.2025, merr këtë,

V E N D I M

HUDHET E PASAFATSHME ankesa A.nr.633/2025 e datës 07.03.2025 e subjektit politik Lëvizja VETËVENDOSJE!, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë administrimit dhe numërimit të votave nga jashtë Kosovës – votave me postë, në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR) në Prishtinë, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025,

A r s y e t i m

Me datë 07.03.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.633/2025 të parashtruar nga subjekti politik Lëvizja VETËVENDOSJE! me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më 5 mars 2025, ditën përmbylljes së procesit të numërimit dhe rinumërimit të fletëvotimeve me postë në ora 15.00, komisionerë dhe vëzhgues të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, kanë identifikuar se në vazhdimësi gjatë këtij procesi, në Qendrën e Numërimit në Prishtinë, fletëvotimet nga vendvotimet me numër VP/ 17/11, VP/17/12, VP/18/06 dhe VP/13/05 (70 fletëvotime) janë shpallur të pavlefshme përkundër faktit se fletëvotimet përkatëse kanë qenë në përputhje me nenin 16 të Rregullores zgjedhore nr. 12/2024 votimi.

Më tej në ankesë theksohet se fletëvotimet janë shpallur të pavlefshme për shkak të një gabimi teknik në shtypjet/printimet e fletëvotimeve përkatëse, përkatësisht printim jo i plotë (disa prej tyre) dhe po ashtu disa të tjera janë shpallur të pavlefshme me arsyetimin se i mungon llogoja, të cilat fakte kanë mundur të jenë gabim teknik me rastin e printimit, mirëpo që vërehet qartë qëllimi i votuesve, bazuar në legjislacionin përkatës zgjedhor.

Lidhur me rastet e tilla, PZAP tashmë ka praktikë me vendimin Anr.623/2025, përmes së cilit për fletëvotimet me problemet e natyrës së njëjtë, ndonëse të shpallura fillimisht të pavlefshme nga komisionerët përkatës në QNR, ka vendosur ti shpallë të vlefshme.

Konkretisht, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, votuesi duhet vet ta shtypë/printojë fletëvotimin nga faqja zyrtare e KQZ-së. Në fletëvotimet përkatëse, gjatë këtij procesi të printimit, vërehet se fletëvotimet, nuk janë printuar si të plota, ndonëse vërehet qartë qëllimi i votuesit.

Parashtruesi i ankesës thekson se sikur nga votuesi të kërkohej fillimisht të votojë e pastaj ta printojë, do të kishte kuptim supozimi se për kë ka votuar nëse fletëvotimi nuk është printuar komplet. Por, meqë ky nuk është rasti dhe votuesi fillimisht ka printuar fletëvotimin në kushte shtëpie, e diktuar ndonjëherë nga formati i dërguar e specifikat krejt teknike e teknologjike, duhet të kihet parasysh qëllimi i votuesit ashtu siç e përcakton edhe Ligji.

Si provë në ankesë ka bashkangjitur Rekomandimin për hapjen e kutive të votimit me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosovë dhe fotografi të fletëvotimeve.

KQZ në përgjigjen e saj lidhur me kërkesën e ankuesit se fletëvotimet nga vendvotimet me numër VP/17/11, VP/17/12J VP/18/06t VP/13/05 të shpallen të vlefshme dhe gjithashtu të rinumërohen dhe të rivlerësohen të gjitha fletëvotimet e dërguara në kutitë postare të KQZ-së, të cilat janë shpallur të pavlefshme për subjektet politike të certifikuara dhe kandidatët, sepse shumica e fletëvotimeve të pavlefshme janë të natyrës, të cilat tashmë janë zgjidhur nga PZAP, sipas Vendimit Anr.623/ 2025 datës 04.03.2025.

KQZ sqaron se në lidhje me vlefshmërinë e këtyre fletëvotimeve, neni 16, paragrafi 2 i Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 2024 Votimi Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, përcakton se një votë është e vlefshme kur është shënuar vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë vullneti i votuesit në të kundërtën, vota konsiderohet e pavlefshme nëse: janë shënuar më shumë se një subjekt politik; nuk është shënuar asnjë subjekt politik; janë shënuar vetëm kandidatët, por jo subjekti politik; qëllimi i votuesit nuk është i qartë.

Bazuar në nenin 3 paragrafi 1.37 të Ligiit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe Procedurën e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve., Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës Kosovës - 9 shkurt 2025, e miratuar me vendimin e datës 25.02.2025, Nr.01/635/2025, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR)- do të thotë lokacioni ku numërohen fletëvotimet me kusht (FK-të), fletëvotimet jashtë Kosovës. dhe Çdo fletëvotim i rregullt siç kërkohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) apo Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia.

Gjatë numërimit të fletëvotimeve në QNR, vlefshmëria e fletëvotimeve dhe votave përcaktohet sipas nenit 16 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024, e cila rregullon procesin e votimit numërimit dhe menaxhimit të vendvotimit.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën dhe përgjigjen në ankesë vëren se ankesa është e pasafatshme.

Pretendimet e parashtruesit të ankesës se ditën përmbylljes së procesit të numërimit dhe rinumërimit të fletëvotimeve me postë më 5 mars 2025, në ora 15.00, komisionerë dhe vëzhgues të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, kanë identifikuar se në QNR në Prishtinë, fletëvotimet nga vendvotimet me numër VP/ 17/11, VP/17/12, VP/18/06 dhe VP/13/05 (70 fletëvotime) janë shpallur të pavlefshme përkundër faktit se fletëvotimet përkatëse kanë qenë në përputhje me nenin 16 të Rregullores zgjedhore nr. 12/2024 votimi, Paneli gjeti se pretendimet e paraqitura për këtë çështje janë të parashtruara pas afatit ligjor për ankimim, pasi që pala ankuese këto parregullsi ka mundur ti paraqes 48 orë nga momenti i njoftimit të KQZ-së ka përfunduar numërimi i votave në QNR në Prishtinë.

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se ankesa është e parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e saj, pasi që bazuar në nenin 105 paragrafi 1 i LZP-së, është paraparë afati për dorëzimin e ankesës me shkrim pran PZAP-së lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dorëzohen brenda 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, ndërsa pala ankuese gjegjësisht subjekti politik LVV ankesën e ka dorëzuar në PZAP me datën 07.03.2025 në ora 14:15 minuta, kurse nga njoftimi i KQZ-së i publikuar në ëeb faqen e tij, procesi i numërimit të votave në QNR në Prishtinë, nga votimi me post jashtë Kosovës ka përfunduar me datë 04 mars 2025 në ora 16:00, që do të thotë se ankesa për këto pretendime është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor prej 48 orëve.

Paneli, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga subjekti politik LVV, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 105 paragrafi 1 i LZP-së, *ku afati për dorëzimin e ankesave lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dorëzohen*, me shkrim pran PZAP-së brenda 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Paneli gjeti se e njëjta është ushtruar pas afatit ligjor, dhe nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 105 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16 të Rregullës 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A.nr. 633/2025 datë 09.03.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.